



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Seancë plenare e Kuvendit

P- 013

Prishtinë, më 4 prill 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË  
4 PRILL 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë janë të pranishëm 95 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në fillim të seancës, Kryetari në emër të Kuvendit, përshëndeti lirimin e ish-kryeministrit, Ramush Haradinaj nga aktakuza e Tribunalit të Hagës, si dhe Republikën e Shqipërisë dhe të Kroacisë për ftesën që u ishte bërë për t'u anëtarësuar në NATO.

**Kryetari** i njoftoi deputetët se, në bazë të rregullave 6. 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**R e n d d i t e:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 28 marsit 2008,

2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Sigurinë private,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

## **1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 28 marsit 2008**

Procesverbali i seancës plenare të 28 marsit 2008 u miratuan pa vërejtje.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Bahri Hyseni** i parashtoi pyetje Kryeministrit të Kosovës: sa shtete e kanë njohur Republikën e Kosovës dhe çka ka ndërmarrë Qeveria që edhe shtetet fqinje ta njohin Kosovën?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bahri Hyseni.

Deputeti **Driton Tali** i parashtoi pyetje Kryeministrit të Kosovës: Cili është qëndrimi i Qeverisë lidhur me Projektin për ndërtimin e Termocentralit “Kosova C” prej 2100MGW?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Driton Tali.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtoi pyetje Kryeministrit të Kosovës: Pse Qeveria e Kosovës ende nuk e ka paraqitur Programin e saj?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Gjylnaze Syla.

Deputeti **Ibrahim Gashi** i parashtoi pyetje Kryeministrit të Kosovës: Cilat janë veprimet konkrete të Qeverisë për të lobuar në ato shtete që refuzojnë apo hezitojnë ta njohin Republikën e Kosovës?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Ibrahim Gashi.

Deputetja **Donika Kada-Bujupi** i parashtoi pyetje Kryeministrit të Kosovës: Cilat veprime i ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për t’i zbuluar “sabotuesit” në KEK?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kada.

Deputetja **Donika Kada-Bujupi** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës: Cila është strategjia e Qeverisë së Kosovës për të dalë nga kriza energjetike?

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kada.

Deputetja **Donika Kada-Bujupi** i parashtroi pyetje Kryeministrit të Kosovës lidhur me punën e ministrave të Qeverisë së Kosovës edhe në UP.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kada.

Deputeti **Gani Geci** i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me demarkacionin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë, si dhe kompensimin e tokave për banorët e fshatit Debelldeh, komuna e Vitisë.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gani Geci.

Pyetjet e tjera të deputetëve, që i kishin parashtruar për seancën e sotme, u shtynë për seancën tjetër të radhës, ngase koha e paraparë për pyetje e përgjigje ( 50 minuta) nuk ishte e mjaftueshme për t'i parashtruar të gjitha pyetjet.

### **3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës,**

**Kryetari** ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, gjatë prezantimit të Projektligjit tha se çështja e përdorimit të vulave në institucionet e Republikës së Kosovës, është një fushë e pambuluar dhe deri më tani e parregulluar me dispozita ligjore, prandaj për këtë arsye është paraqitur nevoja e hartimit të këtij Projektligji dhe rregullimi ligjor i kësaj fushe.

Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i dispozitave ligjore për formën, madhësinë dhe përmbajtjen e vulës, procedurën për mënyrën e punimit, të përdorimit, të ruajtjes si për dhe përgjegjësit për përdorimin e vulës në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Projektligji përcakton përgjegjësitë e institucioneve dhe të personave për mënyrën e pajisjes me vulë, institucionit përgjegjës për dhënien e lejeve për pajisje me vulë, mbajtjen e evidencës për lejet e dhëna, sigurimin e institucioneve dhe të qytetarëve nga çdo lloj i keqpërdorimit të vulës, formën dhe madhësinë e vulës, përmbajtjen dhe sigurimin e barazisë së gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, vënien e një rendi dhe rregulli në vërtetimin e akteve autentike zyrtare të institucioneve, përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, çështjen e arkivimit të të gjitha vulave,etj.

Projektligji është i strukturuar në 6 pjesë, përkatësisht në 31 nene në të cilat parashihen: dispozitat e përgjithshme dhe të veçanta, procedurat rreth punimit të vulës, përdorimin e vulës dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe dispozitat kalimtare.

Në fund, zëvendëskryeministri Ramaj i ftoi deputetët ta miratojnë këtë projektligj.

**Kryetari** hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hajdin Abazi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Esat Brajshori**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Rasim Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Synavere Rysha**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanovic**, si dhe deputetët **Numan Baliq, Gjylnaze Syla dhe Enis Kervan**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70;  
Kundër----- 1.  
Abstenime-----0.

**Kryetari** konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, Projektligjin për vula në institucionet e Republikës së Kosovës, në parim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë private**

**Kryesuesi** ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për sigurinë private.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, tha se nevoja për nxjerrjen e Projektligjit për sigurinë private është që të krijohet baza ligjore për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private nga subjektet afariste dhe personat, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e sigurisë private të njerëzve dhe të pasurisë, e që nuk janë në fushën e përgjegjësiave dhe të autorizimeve të organeve shtetërore.

Qëllimi i këtij projektligji është që në mënyrë unike t’i përcaktojë rregullat ligjore lidhur me subjektet që ushtrojnë veprimtarinë nga lëmi i sigurisë private.

Projektligji është i strukturuar në nëntë kapituj, përkatësisht në 63 nene në të cilat parashihen: dispozitat e përgjithshme, organet kompetente, licencat dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së sigurisë private, masat, autorizimet dhe detyrat e punëtorit të sigurimit, organizimi obligativ i sigurisë, mbikëqyrja inspektuese, evidencat, dispozitat ndëshkuese dhe dispozitat përfundimtare.

Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete buxhetore, por edhe krijohen të hyra për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Në fund, ministri Pajaziti ftoi deputetët ta miratojnë, në parim, këtë projektligj.

**Kryesuesi** hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për Sigurinë private, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për Sigurinë private dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Emrush Xhemaili**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Shkumbim Demaliaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Gani Geci**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Shinik** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanovic**, si dhe deputetët **Ibrahim Gashi**, **Riza Smaka** dhe **Armend Zemaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

**Kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 82;  
Kundër----- 0.  
Abstenime-----0.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, Projektligjin për sigurinë private, në parim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës**

**Kryesuesi** i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues.

**Kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Rezultatit e votimit ishte si vijon :

Për----- 69;  
Kundër----- 2.  
Abstenime-----1.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve**

**Kryesuesi** i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve, si dhe me raportet e komisioneve kryesor dhe të komisionit përgjegjës raportues.

**Kryesuesi** i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte si vijon:

Për----- 78;

Kundër----- 0.

Abstenime-----2.

**Kryesuesi** konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve.

**Kryesuesi** e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

**Përgatiti:**

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale